Titulli i librit :
’’Një gjethe e rënë ’’
Poezi

Autor:
Orgesta Tafa
Redaktor :
Xhevahir Cirongu
Botues ‘’Jozef’’ Durrës
Dhjetor, 2017
ISBN 978 – 9928 – 241 – 60 – 3
1. Letërsia shqipe 2. Poezia
821.18 – 1

"Ah,Ga jetë - mërgimtare
Femijë nga gjiri nënës larguar,
Si zogjtë e barbit shpërndarë
Zjarri i shpirtit tek ne përvluar!"

Orgesta Tafa ka lindur në qytetin Elbasan më 01 .05 1997. Mbaron arsimin e mesëm në gjimnazin ‘’Ahmet Dakli’’ po në qytetin e saj të lindjes, vazhdon studimet e larta në Fakultetin Ekonomik (dega financë) në Universitetin ‘’Aleksandër Xhuvani’’ Elbasan. Por, letërsinë ajo e ka patur pasionin e saj të zemrës qysh në fëmijëri, duke qenë një lexuese e rregullt e librit në përgjithësi, por e atij letrar në veçanti. Ajo merr guximin, e me penën e saj hedh në letër vargun poetik të ngjyrosur me ngjyrat e ylberit shpirtëror. Aty tek ato rreh fort pulsi i dashurisë për jetën, malli për vendlindjen, për njerëzit e dashur të zemrës, për natyrën aq të bukur ku ajo ka lindur. Vargu i shkruar nga kjo poete e re, e fton lexuesin dhe i rrëmben zemrën e dhimbjes e të mallit, për të lexuar vargun e hedhur në letër të poezive të kësaj poete të re. Orgesta Tafa del para lexuesit me librin e saj të parë poetik me titullin ‘’Një gjethe e rënë’’, por lulëkuqet e shpirtit krijues premtojnë rrugëtimin e pandalshëm letrar të saj.

Xhevahir Cirongu – poet

ISBN
Çmimi 400 Lekë

Orgesta Tafa

Një gjethe
e
rënë

(Poezi)

Parathënie

Orgesta Tafa ka lindur në qytetin Elbasan më 01 .05 1997. Mbaron arsimin e mesëm në gjimnazin ‘’Ahmet Dakli’’ po në qytetin e saj të lindjes, vazhdon studimet e larta në Fakultetin Ekonomik (dega financë) në Universitetin ‘’Aleksandër Xhuvani ’’ Elbasan. Por, letërsinë ajo e ka patur pasionin e saj të zemrës qysh në fëmijëri, duke qenë një lexuese e rregulltë e librit në përgjithësi, por e atij letrar në veçanti. Ajo merr guximin , e me penën e saj e hedh në letër vargun poetik të ngjyrosur me ngjyrat e ylberit shpirtëror. Aty tek ato rreh fort pulsi i dashurisë për jetën, malli për vendlindjen, për njerëzit e dashur të zemrës, për natyrën aq të bukur ku ajo ka lindur. Orgesta Tafa udhëton bashkë me mendimin dhe ëndrrat duke fluturuar nëpër qiellin e kaltër, takon yjet e bisedon me ta, i jep puthjen e ëmbël hënës ngjyrë ari, i thotë dashurisë së nënës se jeni mjalti e oksigjeni i jetës sonë, merr frymë thellë e takohet me ajrin e pastër të vendlindjes, Elbasanin që e ka rritur dhe edukuar, por edhe që e nxit për kurajon krijuese për tek vargu poetik.

Duke vështruar e lexuar poezitë e kësaj poete të re , në galerinë krijuese dhe në vargun kolorit, aty do gjesh pjalmin poetik ku fjala e vargu shpërthen fuqishëm bashkë me ndjenjat të vetë poetes, gjithsesi pikërisht është kjo ndjenjë e ngrohtë e fjalës së shprehur që na fton ne si lexues që ta lexojmë poezinë e saj. Libri përbëhet nga 74 poezi. Tematikat e poezive janë kryesisht të planit ndjesor shpirtëror, të cilat pasqyrojnë botën e brendshme të vetë poetes Orgesta Tafa. Por , ajo nuk lë pa hedhur në vargje edhe për vendlindjen, atdheun, flamurin, pra fryma e atdhedashurisë tek kjo poete rreh fort, saqë duket qartë e lexohet me dhimbje kur e merr malli , por edhe dashuri të madhe që s’njeh kufi, deri aty ku ajo këndon bashkë me zogjtë e fshatit, pi ujë nëpër burimet e vendlindjes, deri tek lotdhimbja te varret e të afërmve, ku ledhaton me vargun poetik. gurët e epitafet që janë shkruar aty. Libri ka një titull aq domethënës, saqë poetja rend duke ecur e s’ndalet pas një gjethe të rënë nga pemët aty në rrugicat e qytetit apo të fshatit. Simbolika e gjethes që këputet nga pema, është një tregues rrëfimi i pandalshëm i vetë poetes në këtë rrugëtim të gjatë të jetës sonë. Mesazhet janë të qarta, sepse jeta duhet jetuar bashkë me të mirat apo të këqiat e saj. E tërë dinamika e thelbit të poezisë me titull ‘ ‘Një gjethe e rënë’’ nga ku merr edhe titullin libri i poetes Orgesta Tafa, na jep frymëzim, ngrohtësi, mendim e ëndrra për një të nesrme akoma më të bukur, sepse jeta vjen vetëm një herë, dhe si rezultat i kësaj ajo duhet jetuar. Dhe…. poetja e thotë qartë me vargun e saj të brishtë në dy strofat e fundit të kësaj poezie. Më konkretisht:

‘’ Po qanin gjethet që kishin rënë
Dhe degët sipër në pemë,
Ato kishin mbetur vetëm

Jetime lëvorja në dru.

S'kishin më ngjyra në to
Pa jelek në trup të ftohta,
Të veshur nga ngjyra gri
E nesrmja do lindi përsëri.''

Tek poezia ''Nënë'', poetja e shpreh bukur e me dashur aq të madhe , saqë çdo fjalë e shkruar shkëlqen si rrezet e diellit, frymon ngrohtë e vargu pi qumshtin poetik nga sisa e nënës, prandaj ai lexohet me aq dashuri. E kush s'ka shkruar për nënën të paktën të vetmnen fjalë!? Edhe Orgesta Tafa, na sjell në këtë vëllim poezinë e saj të gdhendur me daltën e shpirtit. Shprehet kështu:

'' U mërzita kur atje shkova
Por ty në zemër emrin,
Me ngjyra lapsi shkrova
Dhe mallin e zjarrt e shova.

……

'' Me lot laj çdo ditë ditët e mija
Nga lerg prandaj vuaj o nëna ime,
Je dritë për sytë e mi si drita
Prandaj fortë të dua. '' .

Ashtu seç e kemi cekur edhe më lartë, poetja lotin e ka si një thesar ku i flet për gëzimet apo edhe për trishtimet e shpirtit. Bashkë me lotin ajo këndon këngën e jetës, por me atë lot shpreh dhe mallin e dhimjes për vendlindjen deri te pragu i shtëpisë, apo parmaku i dritares. Te poezia ''Lot në dritare'' përcjell fuqishëm për tek lexuesi atë dashuri që kemi për vatrën tonë të ngrohtë që ka emrin shtëpi, për parmakun e dritares nga ku soditim qiellin dhe yjet, kopshtet e bukura plot gjelbërim zogjtë nëpër pemë kur në pranverë ia thonë këngës, lulet e mbjella në saksi, deri te bora e bardhë dimrore që zhvesh gjethet e pemëve…..Ja, si e shkruan vargun për lotin poetja Orgesta Tafa, me metaforën e krahasimen aq drithërues. Vargjet janë shkruar me lotin e shpirtit, por ato janë shtruar si një tapet gjelbëror si gjethet e pemëve nëpër fletët e këtij libri. Konkretisht:

'' Nga zemra u shkëput
Te syri ai rrodhi,
Më ra mbi faqe
Dhe zemrën ma mori.''.

Ndërsa tek poezia me titull ‘’Ti pafundësi’’ , mesazhet janë të zjarrta, ato shpërthejnë si një vullkan, vargu e poetja dalin si vullkan zjarresh nga shpirti, duke na thënë qartazi se jeta është një udhëtim që s’ndalet, ajo udhëton me ne së bashku si një pranverë e begatë deri në pafundësi. Pa dashuri s’ka jetë! Vargjet te poezia të shkruara nga poetja janë kuptimplote si:

‘’ Dua që të më flasësh
Të jem kudo me ty,
Po ti them këto fjalë
Tani jemi veç se dy.
Ti edhe unë bashkë
Udhëtojmë në pafundësi…! ‘’

E vetmja ajo që bashkon njerëzit nëpër botë është gjuha Pa këtë komunikim, s’do të ishte e mundur që njerëzit të merreshin vesh me njëri – tjetrin. Gjuha i bashkon popujt. Ata nëpërmjet komunikimit të gjuhës marrin e japin vlera të dijes e të kulturës. Poetja Orgesta Tafa na sjell me një kundërvështrim domethënës e me vlerë, që ta duam gjuhën tonë të bukur shqipe, ta ruajmë e pasurojmë atë, sepse gjuha jonë shqipe është mbretëresha e gjithë gjuhëve të botës. Dhe poetja na sjell këto vargje të bukrua për gjuhën tonë shqipe.

‘’ Rrotull venë e vinë, - të gjitha një kuptim
Me gëzof gjigante mbuluar botën,
Edhe kur gojë s’ke të flasësh, përshkon
Përdor gjuhën - tënde gjithësin shpegon.

Gjuha jonë e bukur, rrënjë Naimiane
Fishta zbukuron, dashuri Lasgushiane;
Fjalë thurin së bashku, 36 shkronjat
Perlë gjuha jonë, ajo më e shtrenjta.’’.

Vargu i shkruar nga kjo poete, e fton lexuesin dhe i rrëmben zemrën e dhimbjes , të mallit e dashurisë, për të lexuar vargun e hedhur në letër të poezive të kësaj poete të re. Orgesta Tafa del para lexuesit me librin e saj të parë poetik me titullin ‘’ Një gjethe e rënë’’, por lulëkuqet e shpirtit krijuese premtojnë rrugëtimin e pandalshëm letrar të saj.

‘ ’ Ah,kjo jetë - mërgimtare
Femijë nga gjiri nënës larguar;
Si zogjtë e korbit shperdarë
Zjarri i shpirtit te ne përvëluar!’’

Poezia është një këngë që këndohet në çdo kohë, të tilla do mbeten si gurë diamatësh edhe poezitë e poetes Orgesta Tafa në lëmin e grunjtë të letërsisë shqipe.
Na mbetët për ti thënë poetes Orgesta Tafa, suksese në këtë udhëtim të bukur krijuese letrare

Xhevahir Cirongu - poet

Durrës, 05, 12. 2017

Mendje e shkretë

Ç’ke që mendohesh
Orë të tëra humbet,
Pse lodhesh kot
Moj mendje e shkretë?

Ç’ke që lëndohesh
Atje ku s`duhet shkon,
Pastaj,··· fillon e qan
Mua më mundon.

Ç’ke që mërzitesh
Në këtë jetë çdo gjë kalon;
Por ti prap s`bindesh
Atje ku do vet shkon..!?

Nuk do të flas më
Bëj si të duash vetë,
S’ kam faj unë që të them
Se ti je mendje e shkretë!?

A mundesh?

Të mbyllësh sytë
Të harrosh gjithçka!...,
Për një moment
A mundesh?

Ti vësh gojës fre
Të mos flasesh pa menduar;
Por vetëm një moment
A mundesh?!

Ta lësh urrejtjen mënjanë,
Dhe zemrës ti hapesh rrugë,
Dashuri të dhurosh pa masë
A mundesh?!

Harroje të kaluarën
Merre jetën në pllëmbë .
Të jetosh pa u ankuar
Me thuaj,
A mundesh ?!

Aty më s’do jem

Kur ditarin ta hapësh
E ta fillosh për ta lexuar,
E di që mes rreshtash - faqesh
Do rendësh për të më kërkuar.

Kur të duash të më shikosh
Albumet gjysmë bosh,
E di që për fotot të cilat grise
Një ditë keqazi do mendosh.

Kur mes pluhurit të dallosh
Atë trëndafil që është tharë,
E di që do ta duash
Përsëri do të jëtë si më parë.

Dhe malli do të marrë
Sytë do mbushen me lot,
Unë aty me s’do jem
Ta them me gojën plotë.

Zjarr i shpirtit

Shumë zemra digjen
Nga largësia.
Nuk ka si familja
Nuk ka si shtepia.

Zemrat e humbura - tanët
Humbur rrugëve nëpër botë;
Diku fshehin zjarrin e shpirtit
Dhe fjalë të djegura ajo thotë.

Ah,kjo jetë - mërgimtare
Femijë nga gjiri nënës larguar;
Si zogjtë e korbit shperdarë
Zjarri i shpirti tek ne përvluar!

Gushti

Punon gjithë vitin….,
Që të vish me çdo kusht,
Të kthehesh në tokën tënde
Pikërisht në gusht.

Ditët duken më të ëmbëla
Çdo gjë shkëlqen si ajër;
Kur në gusht ne vijmë
Njerzit janë më me vlerë.

Prandaj e dua,
E pres gjithë vitin
Të vijnë ato ditë gushti,
Që ta mbush
Me musht rrushi shpirtin.

Fjalë zemre

A koma i kam të gjallë
Pamjen e asaj dite.
Pemët,lulet, qiellin
Që sipër nesh rrinte.

Akoma më rreh zemra
Kur ato fjalë kujtoj;
I gdhenda përgjithmon
Dhe brenda meje jetojnë.

Akoma e ndjej
Nxehtsinë e atij perqafimi,
Që më dhe kur po ikje
Pa datë kthimi…..!

Akoma imagjinoj
Sikur afër më je,
Kujtoj fjalën e zemrës
Që atë ditë më the.

Ti dhe qenien tënde
I kam ngulitur kudo,
Në sy , zemër e mendje
Do rri e vdes me to!

Skutat e memorjes

Në skutat e memorjes
Fshehur shumë kujtime….,
Ëndrra njerëzore
Por edhe zhgënjime.

Si copa të një pazelli
Më hapen vërdallë,
Mundohem ata ti gjej
Dhe….ti lidh ngadalë.

Me kalimin e viteve
Disa janë pluhurosur,
Të tjerat janë zverdhur
Ato që kanë mbetur
Vallë pse janë përlotur!?

Në botën time sërisht
Eci në kopshtin e trëndafilave;
Aty kam lindur
Më ndjekin kujtime
Që s'kanë të mbaruar.

Lot në dritare

U ula pranë dritares
Aty bënte pak ftohtë,
Dikush më trembi
Jo, ai na ishte një lot!

Nga zemra u shkëput
Te syri ai rrodhi,
Më ra mbi faqe
Dhe zemrën ma mori.

Ndjeva një tjetër
Pas tij, seç më ndjeu shpirti,
M'u shfaq në sy
E ndjeva mall.

(…….)
Ai më bëri të vuaj
Nga kjo e tmerrshmja largësi!

Pinoku mashtrues

Duke ecur një ditë takova një shok.
Është i hollë, i gjatë,
Por…edhe finok.
E pyeta për diçka
Thjesht për kuriozitet
Më ktheu diçka tjetët
Me shumë marifet.
Çdo ditë që kalon
Ai shpik diça të re,
Të gjithë i mashtron
….Pa u vënë re!
Kur zë e flet
Njerëzit e dëgjojnë
Është njësoj si pinok
Duke qeshur i thonë.

Zogu

Në dritaren time
Ndaloi një ditë një zog,
Një zog i vogël
I bukur si dritë.
E pashë me vënendje
Zemrën ai ma mori,
Doja ta prekja
Por më hutoi
Lëvizi shpejt
Në qiell fluturoi.
Në mes të kaltërsisë
Humbi papritur
Zgjohem në mëngjes
Shoh barin e kopshtit
Mbuluar me pika vese.
Dëgjoj diçka këtu afër
Më duket cicërima
Ktheva kokën pas
Ishte zogu im.
Erdhi e m'u afrua
Ai zog i vogël
Më zbukuroi edhe mua.
Me ato krahë të vogla
Ngjyra mbushr plot
Të dytë si ai
Zor s'e gjen në botë!

Vajza

Doli dielli, oh sa bukur!
Çelën lulet, ja një flutur,
U rrit bari mrekulli
Prit të rritesh, vjen dhe ti.

Ty gjithmonë të gjen viti
Me shtat hedhur ti moj vajzë,
Rritu, rritu edhe ti
Të të shoh ty nga larg.

Pse më dukesh si fëmi
Erdhi dimri, filloi bora,
U ndërrua edhe ora
Ditë e bardhë si dëbora.

E njëjtë mbete edhe ti
Kalojnë stinët re të bardha,
Shkuan dy, me ty tre
E bukur mbete për mbi dhe.

Vajzë dje, sotë nënë
E bukur porsi hënë,
Që ndrit atje nën tëndë
Si flutur, jo gjethe rënë.

Ti pafundësi

Në fytyrën tënde shoh pafundësi
Sho dritë që hapsirës udhëton,
Në sytë e tu shoh gjithë botën
Të dua, nuk ta them kot.

Në krahët e tua dua të rri
Të më prekësh me ato duar,
Veç se ti.
Krahët e tu mbjellin tek unë
Pranverë e dashuri.

Dua që të më flasësh
Të jem kudo me ty,
Po ti them këto fjalë
Tani jemi veç se dy.
Ti edhe unë bashkë
Udhëtojmë në pafundësi…!

Shpreso….

Kur bota të shembet
Dhe dielli më s’të ngroh,
Mos u dorzo shpejt
Atëhere fillo e shpreso.

Shpresa është rreze drite
Ajo tregon rrugën e nisjes,
S’ka braktisje, o njeri
Shpresa vdes e fundit
Edi, edi këtë e di unë edhe ti.

Ah, kjo shkolla

Ca shkojnë me të keq
Ca me qejf zgjohen,
Që të shkojnë në shollë
Për t'u shkolluar.

Të mësojnë për botën
Dhe për historinë,
Të mësojnë për tokën
Dhe për gjithësinë.

Të dinë si të zbresin
Dhe të numërojnë,
Të bëjnë shoqe – shok'
Bashkë të gjithë tok.

Përqafimi

U bë shumë kohë
Që ne nuk shihemi,
Kur takohemi në rrugë
Lotët na derdhen si lum.

Dhe nata me yje prilli
Erdhi tek ne atë natë,
Kujtimet u zgjuan tek syri
Tunjatjeta thanë të gëzuara bashkë.

Vështrimet kishin kohë pa u takuar
Dhe koha ecte pa u ndjerë tek ne,
Në rrugën me gurë kujtimet ngelur
Si zogjtë që fluturojnë mbi re
Sërisht, bashkë u përqafuam edhe ne.

Realitet i hidhur

Jeta përpëlitet ajo kërkon rrugdalje
Asnjë nuk të ndihmon,
Të gjithë ecin rrugëve si kukulla me bateri.

Asnjë s'e kthen kokën pas
Dhe….për askënd s'do t'ja dijë.
Njerëzimi humbi dhe mbeti histori
Nëpër trupat e disa qenieve
Të cilat janë fasadë.

(……..)
Pyes veten një ditë:
A është ky fundi?!

Qetësi

Çdo gjë atë çast ndaloi
Zhurmë s’dëgjohet më,
Pse kjo qetësi?
As vet s’e di, u fshi.

Ikën pa lënë gjurmë
Në këtë dhomë të vetme;
Më tmerroi, as vet se di.
Sa çudi!?
Gjithçka u zhduk si me magji.
Sa bosh që ndihem
Në shtëpi vetëm qetësi,
Ora nuk ikën, dita si muaj
Nuk e njoha veten
M’u duk e huaj
Kudo mbretëronte qetësi.

Prindërit

Të pyes, të pyes:
Sa e do babën –nënën?
Ju përgjigja me një frymë
Sa qielli sa toka, si hëna.

……
Për ata së ndërroj asgjë
Mallin e dhimbjen i ruaj
Si flori këtu përbrenda.

Përralla

Si një fëmijë humbas
Kur ti flet,
E meditoj thellë….!

Ngjaj me kureshtjen
Si nëpër përrallë,
Mësomë edhe mua
Të bukura përralla.

Erdhi ujku dhe ariu
Pas vjen dhelpra edhe miu;
Me princat heronjë
Që të lënë pa gjumë.

Bota e përrallave
Shumë të magjeps,
Dhe pse nuk jam e vogël
Ato i përshëndes.

Të ua tregojmë të vegjëlve
Nuk është aspak çudi,
Të lutem më thuaj
Përrallë ti a di?

Perëndimi

Oh sa bukur atje në fund
Sikur qielli e toka puthen.
Dielli një lëmsh i zjarrtë
Në det po shkrihet.

Më duket sikur fundoset
Por e sikur ngrihet,
Me ngjyra magjepse
Tani po reflekton.

Dielli në ujë, uji që s'mbaron
Njëherë duket i verdhë
Herën tjetër portokalli
E kuqja më bukur çudi.

Më von ai u bë gri
Dielli u fsheh diku,
Në detin blu
Sërisht u bë qetësi.

…… …Dhe dielli lindi
Erdha na tha përsëri.

Për ty

Qielli u nxi e yjet u fshehën
Lulet s’po çelin nuk di pse,
U strukën kafshët dhe…
Sikur bota shteroi.

S’po shoh dot njeri aty rrotull
Pa dashur, fillon të bjerë shi
Malet u nxinë sikur bota mbaroj
Dukej edhe toka si e shkret.

Duaje vëllanë e motrën e shkret
I digjet shpirti, si druri mbret,
Loton loti sipër te guri
Na digjet shpirti se di as vet.

Udhëto me dashurin në përjetësi
Ndalo pastaj te e shtrenjta dashuri,
Kuptimin e fjalës do kuptosh
Dhe zjarre të tjerë do ndizen në gji.

Pa titull

Një copëz gri muri bërë pis nga lagështia
Për bri atj një karrige e gërvishur keq,
Gjë tjetër s’ka asgjë aty, sa çudi
Vetëm ajo i bën atij si për dreq shoqëri.

Orë të paharrueshme

Kur në atë vend aty vajta
Dhe bukuritë e tij pashë,
I thashë vetes dhe gjyshit të jetoj
Aty s'mbeti asgjë, nuk e di.

E gëzuar thashë, gjyshi hop më mori
Dhe të dy nisëm të flisnim ngadalë,
Për kohën e kaluar, si një kal i marrë
Që të dy qamë të përmalluar.

Tek ai vend sa herë kishim qëndruar
Dhe shpirtin si qëlim aty e shtruam,
Mendimet nuk rreshtin asnjëherë
Puthjet e jetës i lam aty përherë.

Nuse pashkë

Ku po shkon ashtu ngadalë – ngadalë
Bukuri moj nuse pashkë,
Si një lule pranverën ti zbukuron
E kuqe ngjyrë si gjaku thonë.

Si drita ndezur që vezullon
Me hijeshi zemrës i thotë,
Pa pritur ajo vjen e dhuron
Veç mirësi si gjithmonë.

Një gjethe e rënë

Një gjethe u këput
Ajo mbi shpinë më ra,
E ktheva kokën lart
Por… syri gjë s'pa.

Kalova te ajo rrugë
Dhe atje shkela diçka,
Për çudi ashtu se di
Syri atë gjethe e pa.

Eca pak më tutje
Me gjethen e rënë,
Nga ajo gjethe e këputur
Rruga ishte e zënë.

Po qanin gjethet që kishin rënë
Dhe degët sipër në pemë,
Ato kishin mbetur vetëm
Jetime lëvorja në dru.

S'kishin më ngjyra në to
Pa jelek në trup të ftohta,
Të veshur nga ngjyra gri
E nesrmja do lindi përsëri.

Nënë

U mërzita kur atje shkova
Por ty në zemër emrin,
Me ngjyra lapsi shkrova
Dhe mallin e zjarrtë e shova.

Prandaj atë mall se shuaj dot
Të shoh çdo ditë në pasqyrë,
Je jetë e kuptim për mua
Loti i ngrohët bie mi mua.

Me lot laj çdo ditë ditët e mija
Nga larg prandaj vuaj o nëna ime,
Je dritë për sytë e mi si drita
Prandaj fortë të dua.

Mësuesja

Ti më mësove si të numëroj
Ndaj e ty s'të kam harruar,
Më mësove se si të shkruaj
Por….edhe bukur të lexoj.

Sa mall kam për ty
O mësuesja ime,
Për ty unë ruaj të freskta
Të bukura kujtime.

Ato rrënjë kanë zënë
Dhe çelin në zemrën time,
Mësuese e dashur je
Zambak i bardhë tek ne.

E urtë mbete si gjithmonë
Dhe rreze mirësie na jep,
Në fytyrën e qeshur
Fjala e ngelur si fëmija
E ëmbël si në djep.

Mërzitje

Lot më dalin nga sytë
Seç kam as vet se di,
Një brengë po më mbyt
Si fortunë me erë e shi.

Mundohem atë ta harroj
E mbyllur në kyç qenien time,
Pastaj humnerës humbas
Errësirës së mendimeve.

Mall

Sa kam mall
E shkreta zemër
Po më plas….!?

S’duron dot shpirti
Më vjen të bërtas,
Sa shumë e ndjej
Këtu në largësi.

.. …….
Me mendje jemi bashkë,
Me kilometra në pafundësi
Tek malli jam unë edhe ti

Krenari e vrarë

Më fol një fjalë
Ta di që je gjallë!
Më thuaj diçka
Që e qetë të rri.

Më shaj po të duash
Dhe shprehu si do ti.
Nuk do reagoj aspak
Thjesht do të vështroj.

Më fol të lutem
Heshtja të vret,
Thuaj çfarë të duash
Koha më s'pret.

Për ty jam krenare
Të pash, u lëndova,
E shuajte heshtjen
Tek shtegu më dole.

Jeto pa interes

Ditët shkojnë shpejt ikin pa u kuptuar
Ato kalojnë pa u vënë re, sa shpejt,
Fluturojnë vitet si dalladyshet në qiell
Dhe përhumbin në monotoni.

Pas ca gjërave të kota, pa rëndësi
Qëndrojnë njerëz aty përbri,
Asnjë i vërtet, mbuluer me maska
Rrinë të maskuar si për dreq.

Ata qeshin në sy dinak pa shpres
Tek ata lexohet lehtë interesi,
Të hiqen si shokë veç një moment
Kur i kërkon ata më si gjen.

Gjuha shqipe

Rrotull venë e vinë të gjitha një kuptim
Me gëzof gjigante mbuluar botën,
Edhe kur gojë s'ke të flasësh, përshkon
Përdor gjuhën tënde gjithësin shpegon.

Gjuha jonë e bukur, rrënjë Naimiane
Fishta zbukuron, dashuri Lasgushiane;
Fjalë thurin së bashku, 36 shkronjat
Perlë gjuha jonë, ajo më e shtrenjta.

Fshatin ëndërroj

Ëndërroj çdo natë ,sikur jam në fshat
Pranë maleve të lartë, fushave kurorë;
Pranë burimeve me ujë plot Kristal
Me njerëz të mirë, si takoj dot.

Anëve të rrugëve shoh plot gurë
Dhe shtëpitë rrethuar me mure,
Të kthehem, të shtrihem në bar
Duke humbur në qiell, në kaltërsi.

Të marr një gjethe peme të më bëjë hije
Të marr një kokërr fik që ka plot shije,
Të numëroj e zogjtë cicërojnë këngë
Dhe sodis fluturat, iso ato bëjnë.

Dhe ëndrra e dehur aty ajo ndali
Thithi ajër fshati, guri seç i foli,
Shtëpitë e heshtura, eja më thanë
Dhe pastaj ëndrra aty ajo fjeti.

Flamuri

Flamuri kuq e zi valvite krenar
Në qiellin e hapur në kaltërsi,
U ndez zjarre zemrave tanë
Sa të duam një zot e di.

Shqiponja në mes sa të ka hije
Me syt e zes gjak i zjarrtë ndezur;
Mes luftrave gjak i derdhur vatan
Dhe zemra mbushet me krenari.

Ëmbëlsirat……

Në rrugë shoh dyqane
Në vitrinë, çokullata e lëpirëse;
Dhe mendje se heq nga ato dot
Dhe më tutje më shfaqet një tjetër.

Dyqane të rinj e të vjetër
Aty gjen vetëm ëmbëlsira,
Ja dhe gurabie ngjyrë të kuqe
Më tutje një tjetër ngjyrë të bardhë.

E ngrirë mbeta duke i parë
Njerëzit prisnin të gjithë në radhë;
Më dukeshin se ishin bërë për mua
Provomë një herë, e jotja jam
Ëmbëlsira kështu më tha.

Dua …(1)

Dua të jem si lule magjepse
E bukur me shumë ngjyra,
Me krahë si një flutur .

Dua të jem si zog në fluturim
Lart në qiell të lodroj,
Dua të kaloj fusha e male
Dua edhe det, si peshk
Aty të peshkoj.

Dua të jem si valë deti
Gjer te bregu ta takoj
Dua të jem shqiponjë
E shpejt të fluturoj
Dua, dua tëj em….!

Por… dhe atje në shkëmb të qëndroj.
Dua të jem zgalem në suferinë
Askush të mos më ndalojë .
Dua të jem libër i shkruar
Ku të flas në shekuj historia .

Dua t'ju them miqve të mi
Të jemi veçse këngë e bukur,
Dua të jem lule manushaqe
Kënga e lulja t'ju sjelli pranverë.

Dua, dua … (2)

Dua që te qielli të ngrihem
Mbi re atje të lundroj,
Dhe në krahët e nënës
Yjet pastaj ti numëroj.

Me sy ti sodis pak ato
E të thur një kurorë qiellore.
Dua të jem peshk në dete të rri
Të zhytem thellë gjer në pafundësi.

Të luaj me valët e detit blu
Të lundroj botën e tërë,
Të falem o Zot vetëm ty
Ah, sa bukur mrekulli.

Të shkoj lerg në vise pa shkelur
Si zogj shtegtarë të pranverës,
T'u them të gjithëve sa u dua
Me fjalën e ëmbël të zemrës.

Dimër

Mbase dukem i keq, se di
I tillë jam në dukje por….,
Më thonë se je i keq
Ju them se kam edhe butësi.

Por gabohen prapë ,se di se di
Unë vij me erë, bore e shi,
Nuk njoh orë, për mua është çudi
Tek mua do gjeni edhe ngrohtësi.

Dhe ti mos u çudit o njeri
Jam i fundit , të jap gëzim,
Në festa shtëpie edhe dashuri
Që ngroh çdo cep në shtëpi.

Nga zjarri bubulak në oxhak
E dukshme edhe në dëborë,
Trokasin gotat me dashuri
Dhe pjatat plot sa çudi!

Sa bukur duket kjo botë
Kur troket dashuria në derë;
Dhe festat na thonë neve
Kështu u pafsha nga herë.

Deti

Kur shkon në det vërtet
Dielli përplas rrezet a tij,
Mbi ujë vallzojnë si pulbardha
Dhe unë i vështroj ato.

Do luaj me detin si të ishte fëmi
Peshqit lozin si pendë zogjësh,
Atje mes stërkaslave të valëve
Që s'kanë asnjë mbarim.

Ja rëra e nxehtë, të përvëlon
Vrapoj drejt ujit të detit pastaj;
Një valë e bardhë më afrohet
Me dashur atë e përqafoj.

Nxitoj unë ashtu me prap
Eja më thotë deti me nxitim,
Të dua , më do dhe ti
Që të dy në pafundësi.

Dashuria

Shtrihem që të fleh gjumë
Në mendje kalon një lum,
Janë mendimet e mija
Ndaj më merr befasisht ai gjumë.

Janë dashuritë që treten
Dhe mendja shkon shumë larg,
Takon lumturinë – lumdashuri
Të flas, më flet, kush je Ti?

Dhe zemra më rreh fortë
Kur zërin tënd dëgjon,
Sytë e tu më shikojnë
Dashuria vjen pa e kuptuar.

Nuk di ku shkoj e shkreta dashuri
E kërkova në livadhin e saj
U lodha mes kopshtit pa anë
Te rrjeta e dashur ajo kish përfunduar.

Dashuria për atdhe

Tek ty o i dashur atdhe
Zbrazen lumenj dashurie të kulluar,
Aty tek ty gjej takën e bekuar
Dhe dashurit që mban në gj.

Njerëz të ditur nga ty kanë dalë
Nayra u ka falur dashuri,
Krenohen nëpër botë me ty
Ndaj atij falim jetë e dashuri.

Bora

E bardhë ëhtë bora
Ka edhe ftohtësi,
Kur bie mbulon gjithçka
Në tokë unë edhe ti.

Hap dritaren në ballkon
Dhe fresku mirseerdhe thotë;
Fëmijët i gëzohen asaj
Pastaj fillon të shkrijë.

Asnjë nuk mërzit, sa çudi
Të prita një dhe dy ditë,
S'të gjeta dot më prit
Jo, veç ti nuk më mërzit.

1 Qërshori ynë

Sa herë vjen 1 qërshori ynë
I gëzohem festës sonë,
Dhe veten e pyes atë ditë
Sa shpejt jemi rritur!?

Fëmijët marrin dhurata pafund
Nga prindërit më 1 qërshor,
Dhe nëna më puth në ballë
Aty lindin më shumë dashuritë.

Erdhi 1 qërshori ynë
Fatet tona janë lule qërshori,
Fëmijtë mbjellin jetë
Kështu do jesh mot e jetë.

8 Marsi

Gjithçka duket bukur
Dhe fort, bukur shkëlqen,
Kur dita e 8 marsit troket
Poerta e zemrës fort rreh.

Dhe sytë e nënës lotojnë
Asaj kur festën bijtë e urojnë,
Ju buzqesh ëmbël i përqafon
Zemra i ndizet zjarr vullkan.

Atdheu im

Sa gjak është derdhur atdheu im
Sa vuajtje kanë parë këta sy,
Për ty mijra bijë janë vrarë
E morën plumbin në ballë si luanë.

Kalatë e bedenat me gjak mbuluar
Për ty o atdhe jetën dhanë,
Që ti të jesh i lumtur në shekuj
Dhe gjak po të jetë nevoja
Ty o atdhe ta kemi falë.

Mjerimi

Aty në qoshe po shof diçka
Një hije e zezë që duket e gjallë,
Kjo shtëpi e errët, e vetmuar
E zezë, e humbur , e vetmuar.

Hyj brenda të shoh se ç'ka
Një dritare e vjetër, çdi,
Varur në gozhdë një bluzë
E grisur dhe pa krah.

Më tutje shtruar një qilim i grisur
Tregonte mjerimin, dhe dhimbjen,
Si për dreq enë me zhul e hi
Sa keq më erdhi atë çast
Qante, qante ajo shtëpi.

E dashur nënë!

Sa e bukur është bota
Kur ulesh një çast
Në prehrin e nënës!?

E ëmbël duket jeta
Si mjalt blete,
Dhe përqafimet
Kur merr prej saj.

Mbushem me frymë
Dhe oksigjen prej saj,
E marr në sy
Dhe gjithë botën shikoj.

…Dhe zemra rreh më fortë
E dua nënën, fort e përqafoj,
Ajo të jep jetë, me të dua të jetoj!

Bardhë e zi

Pa ngjyra
Pa dritë,
Bardhë e zi.
E hedhur ajo
Pa shpirt.
E tharë
E vrarë,
E rrënuar
E dërmuar
E harruar,
Qarramne pa fund.

Dikur me mua
Tani je larguar,
Të kërkoj
Ku të gjej?
Se di sa shumë
Bardhe e zi
Ah kjo çmenduri!

Jeta

Jeta është një shancë,
Por edhe një mundësi.
Mund të jetë vazhdim
Ose një fillim i ri.

Jeta është një ëndërr
Ku lindin dashuritë,
Dhe zigzaket e hidhura
Rrugëtim me kufi.

Ajo mund të jetë dëshirë
Që bëhet edhe realitet,
Jeta është si ndjenjë
Me rrugë të shkurtra
Sa dhe ti merr dashurit
Në pafundësin magjike.

……..
Jeta si jeta me jetë
Ajo e vetme unike.

E kaluara histori

Ajo çfarë hedh pas
E kaluara ta fsheh,
Asnjëherë ajo s' vdes
Diku e gjallë rri.

Çdo gjë harrohet
As grimca mos kërko,
Mbeten nën hije
Asnjëherë s'dihet.

E kaluara histori
Sa shumë ke gabuar,
Nëse nga jeta diçka
Ka ndodhur, pranoje
E kaluara ka mbetur
Një plagë tek ty .

Shoku im deti

Në det shkoj shpesh
Pak paqe të gjej aty,
Të mos ketë njeri përqark
E vetme aty dua të jem.

Ulem mbi rërën e lagshtë
Ajo pas rrobave më ngjitet,
Atë çast hap një libër të vjetër
Se si më vjen atë ta gris.

Më afrohet uji tek këmbët
Ai më duket sikur më flet,
Se di, s'duroj dot më
Do ti lag dhe ato pak flet.

E di që ai më sheh
Prandaj shpesh shkoj atje,
Aty jam vetëm unë
Dhe i miri shoku im det.

Merre atë fytyrë e vishe

Merre atë fytyrë e vishe
Të ndihmoj, merre e mbaje sa të duash,
E di ajo të shkon, dhe të buzëqesh
Mbaje kudo, një ditë duhet ta heqësh.

Kam frikë se një ditë më von
Do trembesh nga fytyra jote,
Kam frik nëse një i tillë
S'do ti duhesh më kësaj bote.

Çelësi i zemrës

Në një kuti të florinjtë
Ruaj një diçka të shtrenjtë;
Një çels të zakonshëm
Dhe jetës time i jep jetë.

Atë kuti të vogël
E kam strehuar thellë,
E kam lidhur qark me vena
Dhe prej andej ajo më s’del.

Ajo kuti aq e bukur
Tek unë seç rri,
E brisht e me cilësi
Dhe si ar vjen tek ti.

Atë unë nuk e gjeta
Por edhe as nuk e bleva,
Ajo ishte e jotja
Dikur atë ta rrëmbeva.

Bëhemi sikur nuk njihemi!

Në ëndërr më shfaqesh
Të dy jemi pranë,
Kjo që po të them
Ka një të vërtet
Ajo ka një emër
Dhe e quajnë Jetë!

Iluzione të ndezura

Një zë të vakt dëgjoj
Se ç'thotë atë se kuptoj,
Është i mbytur e i thellë
I humbur në humnerë.

Është një ndjenjë…..apo
Një njeri me iluzion,
Por….edhe nuk kupton
Dhe rend dëshira që pulson.

Rend një ëndërr atje diku
Vrapon tek jeta pafundësi,
Takova të nesrmen dashuri
Iluzionet e mija u ndezën përsëri.

Dita e verës

Shndrrit dielli në mëngjes
Sa herë vjen dita e pranverës,
Dhe gjumi zgjohet s'di të flejë
Nga trokitjet që bjen aty në derë.

Të gjithë dalim nëpër lagje
Të qeshur në shpirtin tonë,
Të mbledhim vezë e gurabie
Të mbledhim e lule thanë.

Një mëngjes….

Diçka të magjishme
Kishte ai mëngjes,
Ishte shumë i ftohtë
Dukej sikur s’kishte jetë.

Pa asnjë pikë vese
Kjo s’ishte e zakonshme,
Syri seç na pa pastaj
Dhe dukej çdo gjë e ngrirë.

Nga qielli atje lartë
Dhe deri tak ata drurë.
S’më harrohet ai mëngjes
I mallkoj ndjenjat e mija,
M’i hapi plagët e shpirtit
Gjymtyrët i la të përgjysmuar.

Më zgjo …!

Kur të gjesh guxim
Për t'iu hakmerr padrejtësive;
Me ty at'herë dua të jem.

Më zgjo!
Lëri prapa krahve gjykimet;
Dhe kur të kesh dëshirë
Thuaji jetës të dua.

Dua të shkoj diku
Prandaj të lutem më zgjo;
Dhe e nesrmja atë moment
Jo , e dashur ti mos u tremb!

…….
Atherë lindin shumë dëshira
Dhe ëndrrat zgjohen sërisht,
Të dëgjoj. Më zgjo!

Familja

Nëse ka diçka në këtë botë
Që për mua është gjithçka,
Është nëna e baba,
Dhe si yjet lart në qiell
Janë motër e vëlla.

Nëse ka diçka në këtë jetë
E cila quhet thesar për mua,
Ajo është dashuria për ju
Që si lulet e pranverës u dua.

Familja është çerdhe zogjësh
Ku marrin jetë ëndrrat e mija,
Aty rritet ndjenja e vlera
Familja është e shtrenjtë
Si lulja manushaqe që çel
Sa herë që vjen pranvera.

Si ta quaj…!

Kam diçka në kraharor
Ngazëllehet më gufon,
S’e ç’është , nuk e di
Dita – ditës më ngacmon.

Vjen në gjumë e më ngacmon
Vjen pran’ meje, më tranon,
Ajo është diçka e fortë
Zemra di , ajo s’ma thotë.

Është mall e dëshirë
Është ëndërr s’po e di,
S’po kuptoj, jo se prap s’di
Si ta quaj nuk e di!?

Festat e nëntorit

Në këto data të shënuara
Ndihem krenar që jam shqiptar,
Festojmë të gjithë, pa dallim
Të gjithë bashkatdhetarë.

Janë këto data të bekuara
Ato me gjak janë të larë,
Kujtojmë të gjithë të rënët
Ju thurim këndojmë këngë.

Kudo flamur kuq e zi
Valviten me krenari,
Është dita jote Shqipëri
M'i gëzofsh ditët Liri!

Interes mbete shkretë

Mirmëngjes o interes
Mirmëngjes ju të shkretë;
Dini vetëm fjalë bosh
Dhe përfillni këtë botë.

Por ju nuk shifeni me sy
Mirmëngjes o interes,
Ju me maska jeni veshur
Dhe dukeni si për dreq.

Pa shpirt si akull jeni
Në këtë jetë diçka paguhet;
Mirmëngjes o interes
Mot e jatë kështu do jesh.

Ditë me shi

Ditë e zymtë
Bën shumë ftohtë,
E egër kjo ditë
Rrugët janë bosh.

Ato kanë mbetur jetime
Pa njerëz dhe pemët zhveshur,
Zemra po më qan, sa çudi!
Pas kujtimeve ato vrapojnë

Tek ty ditë erdha unë
Të them që rri e qetë,
Mos u trishto, të them
Dhe pse jasht bie shi.

Romantike

C a trëndafila të kuq
Dhe dy gota me verë,
Unë veshur bukur
Shikimet mbetur në derë.

Dita u fikë, ndriçoj hëna
Dhe yjet rrinin lartë,
Vezullonin bukur mbi re
Dhe sytë i kishin tek ne.

Mundohem dhe unë të vij tek ti
Eja ti japsh kuptim kësaj dite,
E thënë shkurt me pak fjalë
Është romantike, jo përrallë.

Ditëlindja ime

E mbaj mend dhe këtë vit
Ditën e ditëlindjes time;
Sa shumë dhurata e përqafime
Ishte vërtet ditëlindja ime.

Gjithë vitit e prita ditëlindjen time
Tani ajo vallzon bashkë me mua;
Më jep dritë edhe në sytë e mi
Një vit më shumë tani m'u shtua.

E prta atë ditë sa shumë gëzime
Do pres padyshim edhe të tjerë,
Të ulen mbi supe si zogjtë në fole
E të këndojnë ata veç pranverë.

Mbrëmja më lutet

E qetë është kjo mbrëmja
Sa bukur po më duket tani,
Në qiell shndëritin yjet
Për ne ata sigurisht po luten.

E bukr kjo mbrëmje sot
Se di që është veç për mua,
Ja këtu jemi bashkë tani
Ajo është ç'ka unë dua.

E pa qetë duket kjo mbrëmje
Nuk e di a është gjithkund;
Gjithë mirësit më vijn atë çast
U puthën me mua pastaj
Ajo buzmbrëmje ishte e pa qetë.

I bëj një pyetje vetes unë
Sa thellë më duket mbrëmja,
Si një çarçaf mbuloi tokën
Dhe yjet nga qielli m'u lutën,
Në gji tek unë m'u futën.

Mikja ime

E dashur mikja ime!
Për ty po shkruaj sot,
Nuk di se si me këto vargje
Ty të shprehem dot.

Çdo herë që më je dashur
Më jeni gjendur pranë,
Si flutur mes lulesh ti
Më je ulur mbi krahë.

Kur nevojë kam patur për ty
Zjarrin e shpirtit ma ke ndezur në gji,
Sigurisht kemi qeshur e kemi qarë,
Dhe gëzimet na janë shfaqur
Të gjitha si me magji.

Të kujtoj moj mikja ime
E putha një yll për ty pastaj,
M'u ndez zjarri i zemrës
Me mall çdo ditë të kujtoj.

Qielli blu

Qielli atje lart i gjithi blu
Gjithësia e pafundme…..
Asgjë s’duket nga këtu
Qielli e yjet janë blu.

Diku më shfaqet një tym
Në fakt ato ishin re,
Formonin të ndryshme figura
Çudi, sa na habitën edhe ne.

Atje s’ka fund, edhe fillim
Ndriçojnë yjet e hëna mbrëmjeve;
Lodrojnë në qiellin blu pambarim
Dhe unë zhytem i tëri aty.

Kush jem unë?

Në pasqyrë po shoh
Një tjetër shembëlltim,
Por të gjithë e thërrasin
I paskan vënë emrin tim.

Kush jam unë them shpesh
Ulem e meditoj me veten,
Qënkam ajo që dukem, çudi
Dhe asaj prap i shembëllej.

A të kujtohet?

S’e di pse mendja ime
Çdo gjë ajo ka fshirë,
Asnjë s’po më tregon
Sigurisht, i afrova
Edhe një të mirë.

Nuk e di pse kjo zemër
Me emrin tënd ajo më flet;
Dhe atë sa herë që e pyes
Përgjigje s’më kthen.

Të gjithë janë bërë bashkë
Si një grusht lënë jashtë,
Tek ty ishin ata gjithnjë
Kurse mua s’më donin pranë.

A të kujtohet atëherë si ndodhi
Apo si filloi kjo e bukur histori,
Nëse diçka ti mban mend
Mos nguroh, thuama , dua ta di!?

Pyes

U ul dielli, u skuq, u zhduk
Mos vallë ti e ke fajin?!
Ja, ai diell i kuq
Shkoi në det, u shkri, u struk!
E pyeta veten: A do të dali?
Po qielli pse u zbras, u nxi,
Retë po na përsënesnin në qiell
Yjet e hëna u fshehën pas tyre.

Kush do i tregojë rrugën udhëtarit?
Lulet u vyshkën, u zemrua bari,
Dhe degët e pemëve u zhveshën
Hoqën bluzën e gjelbër, sa keq
Dhe presin të përgjumura beharin.

Zhgënjimi

E mora në dorë një fletë
Pastaj lapsin ngjyrë të zi,
Do hidhja në vargje ca fjalë
Të cilat vetëm ajo zemër i di.

S'e zgjata, mendova dy herë
Me laps shkrova pa ndalim,
Mbi atë letër të bardhë
S'mund ta duronte atë tërbim.

Kot' s'e ka thënë njerëzia
fjala të vret më shumë
se një plumb!
Mua ma vodhën një herë shpirtin
E kërkova gjithandej
Por s'munda ta gjej dot
As vet se di nga humbi!

Fund, 12 Dhjetor 2017